

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Beshir Islami kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Jelena Krivokapić, gjyqtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

T. S. F. , me vendbanim në R. e Serbisë.

Pala ankuese/ushtruesi i kërkesës/

Kundër: **N/A**

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015 ,(lënda e regjistruar në AKP me numër KPA44078), të datës 30 Mars 2015, pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 13 Shkurt 2019, merr;

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar Ankesa. e T. F., paraqitur kundër Vendimit KPCC/D/A/267/2015, të datës 30 Mars 2015, (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA44078).**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015, i datës 30 Mars 2015.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 06 Qershor 2007, T. F., (tani e tutje; parashtruesi i ankesës), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP), në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. I njëjti pretendon se është posedues i të drejtës pronësore me 1/1, pjesë ideale, i ngastrës kadastrale me numër ..., në sipërfaqe prej 00.03.38 ha., me kulturë arë e klasit të tretë, e cila gjendet në Prishtinë, ... vendi i quajtur “Drvarski krug”.
2. Në deklaratën e tij thekson se, të drejtën pronësore në pronën e kërkuar e ka fituar në bazë të blerjes, se në këtë pronë ka qenë e planifikuar ndërtimi i shtëpisë familjare dhe deri tek ngastra është sjellë uji i pijshëm. Po ashtu thekson se posedimin e pronës së kërkuar e ka humbur si pasojë e rrethanave që ndërlidhen me konfliktin në Kosovë, të ndodhur në vitet 1998/99, si datë të humbjes e cek datën 20 Qershor 1999, kërkon ri posedimin e së njëjtës me që e njëjta është e uzurpuar.
3. Së bashku me kërkesë, në AKP, ka dorëzuar dokumentet si në vijim;

- Kopjen-përshkrimin e fletës poseduese nr. ..., me nr. Zah.br. ..., lëshuar, me datë 25.05.2007, nga Kadastrin e zhvendosur në R. Serbisë –Enti Republikan i Gjeodezisë –Qendra për kadastër të paluajtshërive Prishtinë –shërbimi për kadastër të paluajtshëmërive Prishtina-qytet ,në bazë të cilës prona e kërkuar ngastra kadastrale numër ..., e cila ndodhet në vendin “Drvarski Krug”, me kulturë arë e klasit të III-të, në sipërfaqe prej 0.03.38ha., figuron në emër të shfrytëzuesit F. S. T., nga Prishtina.
 - Kopjen e Planit me nr. ..., të dt. 30.05.2008, lëshuar në Kadastrin e zhvendosur në R. Serbisë, nga Enti Republikan i Gjeodezisë –Qendra për kadastër të paluajtshërive Prishtinë nr. i Fl. Poseduese ... , në Krushevac ,në bazë të cilës prona e kërkuar, ngastra kadastrale ..., në vendin e quajtur “Drvarski Krug”,me kulturë arë e klasit të III-të, në sipërfaqe prej 0.03.38ha.,figuron në emër të shfrytëzuesit F. S. T., nga Prishtina, me 1/1, pjesë ideale të pronësisë.
 - Letërnjoftimin me numër personal ., lëshuar me datë 05.11.1990, nga MPB Prishtinë, që dëshmon identitetin e palës ankuese.
 - Më vonë në AKP, (me kërkesën e këtij organi për të paraqitur dokumente shtesë, në mbështetje të kërkesës së tij, për të dëshmuar të drejtën pronësore), pala ankuese e ka paraqitur Kontratën e Shitblerjes me nr. ..., të datës 31.07.1969, të Vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me të cilën pala ankuese si blerës e ka blerë pronën e kërkuar nga shitësi, Ivan Vidaka Papović.
4. Njoftimi fillestar i kërkesës për pronën e kërkuar, nga ekipi i njoftimit të AKP-së, është bërë më 27.03.2008, e njëjta është gjet tokë komerciale pa ndërtime dhe e pa uzurpuar. Në te është vendosur shenja se prona është objekt i kërkesës dhe palët e interesuara duhet të paraqesin përgjigjet e tyre në afatin e caktuar. Me 08.06.2011, dhe 11.06.2011, nga ekipi i njoftimit të AKP-së, me prezencën edhe të palës ankuese, prona është gjet po ashtu tokë, e pa ndërtuar dhe e pa shfrytëzuar nga askush, pretendimet e palës ankuese se Q. I. ia ka bllokuar rrugën e kalimit, i njëjti i ka mohuar duke deklaruar se, asnjëherë nuk ka qen rrugë nëpër pronën e tij, ndërsa i njëjti nuk ka pretenduar të drejtë ligjore në pronën e kërkuar.
 5. Sipas Raportit të verifikimit *ex officio* të Sekretarisë së AKP-së, të datës 30.04.2008, në shënimet e kadastrit është gjet se ngastra e kërkuar kadastrale nr. ..., në vendin e quajtur “Lama e Druve”, me kulturë arë e kl. 3, në sipërfaqe prej 0.03.38ha.,evidentohet në Fletën poseduese nr....., në emër të D. (F.) Q., kjo gjendje datonte prej vitit 1987 e këndeje.
 6. Sipas raportit tjetër të verifikimit të dt. 03.02.2014, nga AKP, në kadastër sipas Certifikatës së drejtës pronësore,(CDP), prona e njëjtë është gjetur e regjistruar në emër të Sh. M. në bazë të kontratës së shitblerjes.
 7. Nga raporti i konsoliduar i verifikimit i AKP-së, i datë 29.07.2014, dokumentet e ofruara nga pala ankuese si, Kontrata e shitblerjes së pronës së kërkuar, nr.Ov.br...,e dt. 23.07.1969, dhe

fleta poseduese janë verifikuar negativisht. Sekretaria ka gjetur se personi nga i cili pretendon se e ka blerë pronën pala ankuese I. V. P., nuk figuron në kadastër se ka qenë pronar i pronës së kërkuar si pronar i më hershëm e as pronar aktual, ndërsa sipas shënimeve në kadastër së paku prej vitit 1987, prona evidentohet në emër të personave të tretë, ndërsa sipas verifikimit të fundit pronar aktual është Sh. M.

8. AKP-ja pas rezultatit negativ të verifikimit të dokumenteve të lartë cekura pronësore, si orvatje shtesë i ka dërguar palës ankuese letër informuese me datë 11.11.2014, për refuzimin e mundshëm të kërkesës së tij ndërsa nga ai është kërkuar të ofroj dokumente shtesë nga të cilat do të dëshmohej e drejta e tij në pronën e kërkuar, por edhe pas afatit të dhënë prej 15 ditë si dhe gjer në vendosjen në këtë organ, i njëjti nuk ka paraqitur dokumentet e kërkuara.
9. Me Vendimin KPCC/D/A/267/2015, të datës 30 Mars 2015, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje: KKPK), e ka refuzuar kërkesën e palës ankuese. Në arsyetimin e Vendimit kolektiv në paragrafin 70-71, theksohet se paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës së tij ka paraqitur fletën poseduese dhe kopjen e planit të vitit 2007, të lëshuar nga arkiva e zhvendosur kadastrale, që e identifikojnë paraqitësin e kërkesës si pronar të vetëm të pronës së kërkuar. Si mbështetje shtesë ka paraqitur kontratën e shitblerjes të lidhur në vitin 1969, në mes tij si blerës dhe V. P. si shitës, e cila kontratë nuk ka mundur të verifikohet nga sekretaria ekzekutive si e vërtetë. Megjithatë sekretaria ekzekutive ka gjetur *ex officio*, parcelën e kërkuar në të dhënat kadastrale në Kosovë të regjistruar në emër të palës së tretë që nga vitit 1987. Në përpjekjet shtesë nga sekretaria, nga pala ankuese është kërkuar të ofroj dëshmi shtesë për të provuar të drejtën e tij, por i njëjti ka dështuar të bëjë një gjë të tillë. Andaj komisioni bazuar në dëshmitë para tij arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën e tij pronësore, ose çfarë do të drejta tjetër pronësore për pronën e kërkuar, menjëherë, para, ose gjatë konfliktit të viteve 1998-99, andaj rrjedhimisht kërkesa duhet refuzuar.
10. Me datë 25 Maj 2015, Vendimi i KKPK-së, i ishte dorëzuar palës ankuese. Me datë 19 Qershor 2015, ka ushtruar ankesë kundër tij.

Pretendimet e palës ankuese

11. Pala ankuese vendimin e KKPK-së, e atakon për shkak të, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.
12. Në arsyetimin e ankesës ndër të tjera thekson se; nuk janë të qëndrueshme konkludimet si në vendimin e ankimuar, sepse në shkresat e lëndës ekzistojnë dëshmitë nga të cilat padyshim vërtetohet se ky është pronar i vetëm ligjor i pronës së kërkuar, në bazë të Fletës Poseduese ..., Komuna Kadastrale Prishtinë të dt. 16.01.2014, të cilën pronë e ka blerë në vitin 1969, nga P. V. I., në bazë të kontratës të vërtetuar në Gjykatën Komunale Prishtinë, se këtë pronë nuk e ka tjetërsuar apo shitur asnjëherë, se shërbimi kadastral në Prishtinë nuk i

ka lëshuar historinë e kësaj prone, po ashtu thekson se nga të gjitha provat dëshmohet se pronën e kërkuar e ka humbur për shkak të rrethanave nga konflikti i armatosur i ndodhur në vitin 1998/99, se të drejtën e tij në pronë e mbron edhe KEDLNJ, protokollet e saj, dhe konventat e tjera të cekura si në ankesë, si dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, etj.

13. Në fund propozon që Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, të nxjerrë vendim me të cilin në tërësi aprovohet ankesa e tij, të vërtetohet se nuk është valid regjistrimi i të drejtës pronësore në pronën së kërkuar në dobi të NN personit, dhe të urdhërohet që të fshihet nga regjistri kadastral, dhe të vendoset gjendja e më parme.

Pranueshmëria e ankesës

14. Ankesa është e pranueshme sepse është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditë nga dita e pranimit të Vendimit të KKPK, siç është paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale.
15. Ankesa u shqyrtua në kuptim të nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006, mbi Procedurën Kontestimore, (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008), (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjen se, ***ankesa është e pa bazuar.***

Arsyetimi ligjor

Juridiksioni

16. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja, ka kompetenca për t'i zgjidhur kërkesat që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me te, ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë, në periudhën ndërmjet 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999. Prandaj, paraqitësi i kërkesës nuk duhet vetëm të vërtetojë të drejtën e tij pronësore mbi pronën e paluajtshme private por gjithashtu duhet të dëshmojë se ai apo ajo, nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur.
17. Duke u nisur sipas pretendimeve në ankesë dhe ekzaminimit edhe *ex officio* të Vendimit, në këtë lëndë është e nevojshme të përcaktohet se, nëse pala ankuese ka paraqitur prova se ka qenë pronar i pronës së kërkuar, se e ka pas në posedim dhe shfrytëzim gjer në periudhën 1998/99, dhe të njëjtën pronë pastaj e ka humbur si pasojë e konfliktit të viteve 1998/99.

18. Sipas KKKP-së si në vendimin e saj, dhe pretendimeve në ankesë, vërtetohet se pala ankuese të drejtën e tij e mbështetë në dokumentet të cilat i bashkëngjit, si fletën poseduese, kopjen e planit të nxjerra në kadastrin e zhvendosur në Serbi si dhe Kontratën e shitblerjes së pronës së kërkuar në vitin 1969, të blerë nga P. V. I. nga ,R e Serbisë, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Është fakt se këto dëshmi të paraqitura nga sekretaria e ekzekutive e AKP-së, nuk është arrit të verifikohen si ekzistuese, ndërsa ky organ *ex officio* në organet kompetente kadastale në Kosovë ,të cekura si më lartë si në parag. 5, dhe 6 të këtij aktgjykimi dhe si në shkresat e lëndës ka gjetur se, prona e kërkuar në kadastrë së paku prej vitit 1987, e këndeje në librat kadastral, ka qen e regjistruar në emër të personit të tretë. Andaj nga dëshmitë e ofruara, KKKP arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës, ka dështuar të tregoj të drejtën pronësore në pronën e kërkuar apo çfarëdo të drejte tjetër pronësore , menjëherë, para, ose gjatë konfliktit të vitit 1998-99, dhe humbja e posedimit nuk ndërlikohet me rrethanat e konfliktit të armatosur.
19. Nga gjendja konkrete e çështjes, në rastet kur e drejta e pronësisë fitohet nga veprimi juridik ashtu si parashihet në nenin 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (ZG RSFJ nr.6/1980, përcaktohet se në bazë të veprimit juridik, (në këtë rast konkret është Kontrata mbi shitblerjen e vitit 1969),e drejta e pronësisë mbi pasurinë e pa luajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik,(librin kadastral), ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.
20. Gjykata Supreme vlerëson se, nuk provohet me asnjë fakt se Kontrata mbi shitblerjen në bazë të cilës pretendon se është bërë pronar i pronës së kërkuar, ishte ekzekutuar ndonjëherë duke u azhuruar në Operatin Kadastral në Kosovë-Prishtinë, në emër të tij edhe pse nuk ka pas pengesa juridike apo rrethana të tjera praktike për tu regjistruar-azhuruar prona në emër të tij si blerës, duke pasur parasysh se e njëjta ishte lidhur në vitin 1969. Po ashtu kjo pronë sipas referimit të AKP-së, nuk ishte gjetur e regjistruar më parë as në emër të palës shitëse. Andaj paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmoj të drejtën pronësore në emër të tij
21. Dokumentet e lartë cekura në të cilat pala ankuese e bazon të drejtën e tij duke i cekur dhe paraqitur si prova edhe në ankesë, janë verifikuar nga sekretaria negativisht, si jo ekzistuese, të cilat në KKKP, janë administruar si prova si në paragrafin 70-71, të vendimit grupor, andaj nuk është i qëndrueshëm konkludimi në ankesë kur thekson se, këto prova e në veçanti kontrata mbi shitblerjen, nuk janë marrë parasysh dhe nuk janë shqyrtuar në mënyrë serioze nga KKKP-ja, sepse si dëshmi të tilla nuk janë gjetur në organet kompetente në organin Kadastral të K. Prishtinë e as në Gjykatën kompetente.
22. Sipas verifikimit *ex officio* , nga sekretaria e AP-së në vitin 2008, prona e njëjtë është gjetur e regjistruar në emër të D.(F.) Q., si pronar i kësaj prone që nga viti 1987, ndërsa nga viti 2014, sipas raportit të verifikimit të dt. 02.03.2014, në bazë të kontratës së shitblerjes kjo pronë është e regjistruar në emër të Sh. (G.)M., (provë në shkresa të lëndës raporti i verifikimit i

dt.30.04.2008, Ekstrakti nga Fletë posedimi i dt. 30.04.2008, bashkangjitura në faqe 071-075, të kësaj lënde, si dhe referati i AKP- faqe 090-091, në lëndë).

23. Është e qartë se ekziston një mospërputhje midis të dhënave në Zyren kadastrale në Prishtinë, dhe atyre në arhivat kadastral për Prishtinën të zhvendosura në Serbi, por megjithatë me asnjë provë të administruar nga AKP-ja, nuk është gjetur se në Kadastër në Prishtinë është regjistruar në libra kadastral prona e kërkuar në emër të tij si blerës, në bazë të Kontratës së shitblerjes, andaj nga këto fakte konstatohet se nuk ka prova të fitimit të pronësisë në mënyrë ligjore, ashtu si parashihet sipas kushteve nga neni 33 të Ligjit për Mardhënjët Pronësore Juridike,(Gaz. Zyrt. e RSFJ 6/80).
24. Gjykata Supreme konsideron se faktet e lartpërmendura shpjen në përfundim se humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar nuk është rrjedhojë e konfliktit të armatosur të ndodhur gjatë viteve,1998-1999, andaj pretendimet e palës ankuese edhe në këtë drejtim kur thekson se; padyshim se e ka pasur pronën e kërkuar në pronësi në mënyrë ligjore dhe këtë të drejtë e ka humbur për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur, refuzohen si jo të qëndrueshme, sepse nuk provohet me asnjë provë, se pronën e kërkuar e ka pas në posedim dhe pronësi në mënyrë ligjore apo çfarëdo të drejtë tjetër pronësore në pronën e kërkuar, në periudhën kohore , menjëherë, para, ose gjatë konfliktit në vitet 1998-99.
25. Prandaj Gjykata Supreme vlerëson se Vendimi i kundërshtuar i KKPK-së, është marrë me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi këtë bazë edhe ligji material edhe ai procedural janë zbatuar në mënyrën e duhur, me mënyrën e vendosjes duke e refuzuar kërkesën për shkak të mos mbështetjes në dëshmi relevante dhe valide.
26. Pala ankuese sipas pretendimeve në ankesë, për veç se i mbështet theksimet si në kërkesën e tij duke i përsëritur theksimet e njëjta, nuk ka bashkangjitur asnjë dokument shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij, për të provuar të drejtën e pretenduar pronësore , andaj nga kjo gjendje e fakteve të cekura edhe si më lartë, realisht dëshmohet se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar.
27. Gjykata gjatë shqyrtimit të kësaj lënde *ex officio* gjen se, Vendimi individual që i referohej kërkesës me numër KPA44078, ishte i përfshirë me gabim gjuhësor por që ky gabim nuk ndikon në përmbajtjen e qështjes së vendosur. Në vendimin individual në gjuhën serbe thuhet se kërkesa ishte “*bedbur*”, kurse në vendimin grupor në të trija gjuhët zyrtare në përdorim dhe në vendimin individual në versionet në gjuhën shqipe dhe angleze thuhet se kërkesa ishte “*refuzuar*”.
28. Sipas dispozitave materiale përcaktohet se në rast mospajtimi apo ndryshimi në mes të versionit në gjuhë angleze dhe versionit në gjuhët e tjera, versioni në gjuhë angleze mbizotëron, bazuar në nenin 3.3, të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5, për

implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ku parashihet se, *“Kurdo që paraqitet ndonjë dallim apo papajtueshmëri në lidhje me ndonjë fjalë, frazë apo interpretim ndërmjet verzionit në gjuhën angleze të dokumentit apo vendimit karsbi verzionit në gjuhën shqipe apo serbe, fjala, fraza apo interpretimi në gjuhën angleze do të mbizotërojë dhe do të përdoret”*.

29. Prandaj me që vendimi burimor grupor në të trija gjuhët, dhe ai individual në gjuhë burimore angleze dhe gjuhë shqipe figuron se “refuzohet kërkesa”, nuk është me ndikim gabimi gjuhësor në vendimin individual në gjuhë serbe, sepse duhet të jetë, “kërkesa refuzohet“, e jo kërkesa hedhet, sepse interpretimi dhe verzioni në gjuhë angleze mbizotëron si origjiner dhe si i tillë përdoret.
30. Ky aktgjykim nuk paragjykon ndonjë të drejtë pronësore për palët, e as që paraqet pengesë për iniciimin e procedurës pranë organit kompetent apo gjykatës kompetente, për tu shqyrtuar çështja pronësore në baza ligjore nëse palët e gjejnë me interes ligjor.
31. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3 (c), të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm, nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

GSK-KPA-A-276-2015, me datë 13 Shkurt 2019

Bashkp. Profesional,

Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,

Beshir Islami